

AKT NORMATIV
Nr. 23, datë 26.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 15.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA ADMINISTRATIVE GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 7/2, fjalia "Në çdo mjedis shërbimi ndalohet muzika pas orës 20:00." zëvendësohet me "Orari i ndalimit të muzikës në mjediset e shërbimit përcaktohet rast pas rasti me urdhër të ministrit të Brendshëm, pas rekomandimit të Komitetit të Përkohshëm për Infekcionin e Përhapur nga Corona Virus".

b) Në pikën 11, fjalët "... dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë trevjeçare dhe me bllokim të mjetit." zëvendësohen me "... dënohen me masë administrative me pezullimin e lejes së drejtimit për 30 (tridhjetë) ditë dhe me masën administrative plotësuese të bllokimit të mjetit për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh."

Neni 2

Shlyerja e masave administrative

Masat administrative të vendosura nga autoritetet shtetërore përkatëse, sipas pikës 11, të nenit 3, të aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për heqjen e lejes së drejtimit apo masat e tjera të bllokimit të automjeteve humbasin fuqi, nëse nga periudha e marrjes së masave është përmbushur afati prej 30 (tridhjetë) ditësh, i parashikuar në shkronjën "b", të nenit 1, të këtij akti normativ.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe